# PROGRAMI I PUNËS SË NDIHMËSDREJTORIT

viti shkollor 2026/2027

Programi vjetor i punës së ndihmësdrejtorit i përfshin fushat e mëposhtme:

- Puna administrative-organizative
- Dokumentet programore
- Puna pedagogjiko-instruktive
- Puna analitiko-hulumtuese

## Puna administrative-organizative

| Përmbajtja e aktivitetit | Qëllimi i aktivitetit | Mënyra e realizimit | Koha e realizimit | Realizuesi |
|---|---|---|---|---|
| Pjesëmarrja në përpilimin e planit për angazhimin e kuadrit mësimor sipas lëndëve, orëve dhe kujdestarëve të klasave | Përgatitje me kohë për fillim të suksesshëm të vitit të ri shkollor | Mbledhje, punë në ekip | Gusht – shtator | Drejtori, ndihmësdrejtori, shërbimi profesional |
| Organizimi për zbatimin e trajnimeve për nevojat e mësimdhënësve | Informim me kohë i mësimdhënësve me qëllim të sigurimit të kushteve për zhvillim profesional | Njoftime, punë në ekip | Shtator | Drejtori, ndihmësdrejtori, shërbimi profesional |
| Pjesëmarrja në përpilimin e orarit për mësimdhënësit dhe për mësimdhënësit kujdestarë | Caktimi i kujdestarisë së mësimdhënësve me qëllim të sigurimit të rendit dhe disiplinës më të madhe | Njoftime, punë në ekip | Shtator – qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori |
| Propozimet për furnizim me mjete pamore, materiale dhe të ngjashme për nevojat e mësimdhënësve dhe nxënësve | Sigurimi i kushteve më të mira për punë të mësimdhënësve dhe përvetësim më i lehtë i përmbajtjeve mësimore nga nxënësit | Punë në ekip, bisedë me mësimdhënësit | Shtator – qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori |
| Vëzhgimi i ditarëve elektronikë për punën mësimore | Përditësimi i evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik | Vëzhgime të drejtpërdrejta | Shtator – qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori, administratori |
| Përgatitja për mbajtjen e Këshillit të mësimdhënësve dhe të klasës | Pjesëmarrje aktive e të gjithë faktorëve në organizimin dhe realizimin e punës edukativo-arsimore | Takime konsultative, punë në ekip, mbledhje | Shtator – qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori |
| Organizimi për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë | Shpërndarja e nxënësve sipas paraleleve | Bisedë dhe konsultime me mësimdhënësit e klasave dhe shërbimin profesional | Gusht | Drejtori, ndihmësdrejtori, shërbimi profesional |
| Pjesëmarrja dhe ndihma në organizimin e patronatit të shkollës | Përgatitja e nxënësve për pjesëmarrje në shënimin e patronatit të shkollës | Orar, njoftime, raportime | Mars – maj | Drejtori, ndihmësdrejtori, shërbimi profesional, kryetarët e aktiveve profesionale |

| Përmbajtja e aktivitetit | Qëllimi i aktivitetit | Mënyra e realizimit | Koha e realizimit | Realizuesi |
|---|---|---|---|---|
| Pjesëmarrja dhe ndihma në organizimin e garave shkollore | Gara shkollore, komunale dhe rajonale të organizuara me sukses | Njoftime, raporte | Mars – maj | Drejtori, ndihmësdrejtori, kryetarët e aktiveve profesionale |

## Dokumentet programore

| Përmbajtja e aktivitetit | Qëllimi i aktivitetit | Mënyra e realizimit | Koha e realizimit | Realizuesi |
|---|---|---|---|---|
| Përpilimi i programit vjetor për punë të shkollës | Respektimi i rregulloreve ligjore | Raport për shkallën dhe cilësinë e realizimit të Programit vjetor | Gusht | Drejtori, ndihmësdrejtori, ekipi për përpilimin e programit |
| Përpilimi i programit individual vjetor për punë të ndihmësdrejtorit | Përgatitje me kohë për punët dhe detyrat e punës për vitin rrjedhës shkollor | Raport për realizimin e aktiviteteve të deritanishme | Gusht | Ndihmësdrejtori |

## Puna pedagogjiko-instruktive

| Përmbajtja e aktivitetit | Qëllimi i aktivitetit | Mënyra e realizimit | Koha e realizimit | Realizuesi |
|---|---|---|---|---|
| Dhënia e udhëzimeve për përpilimin e planifikimeve të nevojshme për realizim të suksesshëm të programit mësimor | Përcjellja dhe avancimi i punës edukativo-arsimore | Udhëzime për punë për mësimdhënësit fillestarë | Shtator | Drejtori, ndihmësdrejtori, mentori, shërbimi profesional |
| Analiza e suksesit të nxënësve | Përmirësimi i suksesit të nxënësve | Vizita të orëve | Shtator – qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori, mentori, shërbimi profesional |

## Puna analitiko-hulumtuese

| Përmbajtja e aktivitetit | Qëllimi i aktivitetit | Mënyra e realizimit | Koha e realizimit | Realizuesi |
|---|---|---|---|---|
| Analiza e punës dhe rezultateve nga zbatimi i projektit për integrim ndëretnik (…) | Analizë sasiore dhe cilësore dhe përcaktim i dobisë nga zbatimi i projekteve | Vëzhgime të drejtpërdrejta, analizë | Maj – qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori, shërbimi profesional, Ekipi për integrim ndëretnik |
| Raport për shkallën dhe cilësinë e realizimit të programit vjetor të shkollës | Pamje reale e rezultateve të arritura dhe përcaktim i qëllimeve prioritare për vitin e ardhshëm | Punë në ekip, raport | Qershor | Drejtori, ndihmësdrejtori, pedagogu, psikologu, ekipi për vlerësim |

**Ndihmësdrejtor:** Violeta Trajkoska